

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 12 MAJ 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Sot jemi sërish në një diskutim për raportimin e një institucioni tjetër të pavarur, i cili, sigurisht, emërtimin e ka korrekt, pra është një institucion i pavarur, por për sa i takon raportimit, mënyrës dhe ndikimit në jetën publike, ekonomike dhe shoqërore, për fat të keq, këto institucione të pavarura nuk shkojnë më larg nga ajo që mund të konsiderohen, thjesht dhe vetëm leva të partisë, sepse që në momentin që zgjidhen nga një maxhorancë e caktuar, një nga detyrat e mëdha që i vënë vetes pa ekuivok, është që të shqetësojnë sa më pak qeverisjen, të jenë sa më pak protagonistë dhe absolutisht të mos ngrihen në atë lartësi që kërkon saktësisht pozicioni i tyre.

Ata duhet të jenë mbështetësit më të mirë të interesit publik, të rregullave dhe të ligjeve, të cilat rregullojnë mbarëvajtjen e kësaj shoqërie, por sigurojnë, në radhë të parë, edhe mbarëvajtjen e jetës së qytetarëve. Situata në të cilën bëhet ky raportim, për fat të keq, është një nga momentet ku protagonizmi pozitiv në përputhje me ligjin, jo përtej ligjit, i këtij institucioni, duhet të kishte qenë i dukshëm dhe përcaktues, pasi qeveria, përtej çdo logjike, përtej çdo imagjinate dhe përtej çdo lloj funksionimi (modelet kanë qenë pa fund në Ballkan, në Europë e më gjerë, në mënyrë të veçantë me problemin kritik dhe dramatik të rritjes së çmimeve), ka zgjedhur në mënyrë abuzive formën më të shëmtuar të pazarit mes qeverisë dhe monopoleve, duke ngritur të ashtuquajturin “Bord” me komisionet brenda e të tjerë, të cilët në themelin e tyre vendosin marzhin e fitimit.

Pra, thënë më thjesht, vendosin se sa do të fitojë privati, por jo se sa do të lehtësohet qytetari, sepse taksat që merr qeveria mbeten të njëjtat, të paprekura dhe të pandryshuara dhe qeveria thjesht dhe vetëm “fërkon barkun” (metafora qëndron në këtë rast), se po mbledh disa qindra e miliona euro më shumë, ku më e pakta gjë që do të duhej të bënte (të gjithë duhet ta kuptoni në këtë sallë, në qoftë se do të kishte një sens humanizmi, kuptohet, se në shumë raste verbëria politike e vë përfund këtë sens), do të ishte që këto para të përdroreshin si subvencion për çmimet përkatëse të ushqimeve dhe qytetari t’i merrte ato me vlerë sa më të ulët monetare. Sigurisht, të gjithë qytetarët pyesin: për cilat arsye

objektive, ekonomike, sociale apo natyrore qytetari shqiptar duhet të jetë inferior ndaj qytetarit maqedonas, apo shqiptar qoftë, që jeton në Maqedoni?

Këtë pyetje e bëj vazhdimisht. Përgjigjja dihet nga të gjithë, por, sigurisht, maxhoranca nuk ka përgjigje për këtë gjë. Maqedonia pa det, që nuk prodhon naftë, me një relief natyror shumë pak të lakmueshëm në raport me Shqipërinë, me akses në rrugët ndërkombëtare e të tjera, litrin e naftës e ka 1670 lekë të vjetër, ndërkohë që Shqipëria e ka 2400 lekë të vjetër. Kjo është përgjigjja që presin shqiptarët e jo dokrrat e tipit “si e gjetëm; si e morëm e si e bëmë”. Po, Maqedonia është atje dhe të gjitha çmimet përkatëse, edhe çmimet e ushqimeve bazë të shportës, të mbijetesës, janë të gjitha shumë inferiore.

Për ç’arsye? Sepse shteti është i përgjegjshëm dhe të gjitha autoritetet veprojnë në mënyrë transparente. Çfarë bëmë ne? Në vend që të vendoste të mbante qëndrim ndaj taksave, që mund të ishte edhe i përkohshëm, jo definitiv, për sa kohë kriza mbijeton, qeveria e pakontestuar, e pakritikuar nga kurrkush dhe në mënyrë të veçantë nga këta që janë mekanizma të pavarur, zgjodhi të vazhdojë spekulimin e saj. Në këto kohë, të ashtuquajtura “kohë krize, kohë lufte” (se për çdo gjë ne kemi dëgjuar pa fund recitime, edhe të nivelit mizerabël, intelektual, për luftën në Ukrainë e të tjera, muhabete të kësaj natyre), kërkohej thjesht dhe vetëm që qeveria të sillej si një qeveri që i rri në krah popullit dhe jo si qeveri spekulante, si qeveritë kuislinge dhe spekulante, që fitojnë gjithmonë në kohë luftërash.

Kështu është qeveria aktuale. Ju e dini se për produktet strategjike, si mielli dhe buka, ky institucion që raporton sot ndërmori një hetim të gjatë prej gati 2 vjetësh, ku qeveria u shpreh se nuk ndërhynte fare, se kjo është një qeveri që, siç e merr urdhrin nga oligarkët, ashtu edhe vepron, por në momentin që tha se nuk do të ndërhynte dhe e la të rritej ky çmim, barra ra e gjitha mbi qytetarët, që e morën bukën dhe miellin me çmim më të lartë, ama taksat iu paguan qeverisë po njësoj. Qeveria papritur krijoi këtë bord, që është një kartel i vërtetë, kush e mohon këtë s’ka respekt për veten e vet. Dihet që në tavolinë ulen disa njerëz të biznesit me disa njerëz të qeverisë, të gjithë bashkë, që një herë në javë apo në 10 ditë caktojnë atë marzhin e fitimit të radhës, ndërkohë që arka e shtetit mbushet, ndërsa xhepi i qytetarit të varfër zbrazet përditë.

Në çdo familje përditë bëhen llogaritë si do të mbijetojnë dhe a do t’ia dalin deri në fund të muajit, ndërkohë qeveria thotë se kemi lekë dhe këto lekë që mblidhen, 200 e ca milionë euro më tepër, përtej parashikimeve, nuk u kthehen qytetarëve, pra atyre nuk u lehtësohet asgjë. Maqedonia është prova, pasqyra. Le të ngrihet një nga qeveritarët këtu dhe të më thotë që në Maqedoni buxheti i shtetit është më i lartë se në Shqipëri, të më tregojë, të më flasë për portet maqedonase dhe të më thotë se ku laget

me det Maqedonia, të më vërë përballë atë që bën Maqedonia për mbrojtjen e bizneseve, sa subvencionon, në mënyrë të veçantë në kohë krize, sa subvencionoi për çmimet e të gjithë artikujve, përfshirë edhe artikujt e domosdoshëm të shportës dhe çfarë ndodhi këtu.

Në fund të fundit, i gjithë mekanizmi i bordit ishte një cenim i hapur i konkurrencës. Për këdo që thjesht do ta dëgjojë, që nuk merret me ekonomi të madhe, është e qartë që një marzh fitimi i përcaktuar dëmton bizneset, mijëra biznese të vogla, sigurisht bën të lumtur oligarkët, të cilët kanë luksin të punojnë me marzhe fitimi edhe më të ulëta, sepse qarkullojnë sasi gjigande dhe kanë monopolin e tregut. Pra, është një mundësi e artë për qeverinë për të sakatuar dhe asgjësuar të gjithë biznesin e vogël kapilar, i cili është një biznes, po e përsëris, me aktivitet mbijetese, jetojnë, mbajnë gjallë nuklin familjar. Pra, i asgjësojnë, sepse, sigurisht, kjo fetë tregu që ata lënë do të rrëmbehet me grykësi nga oligarkët klientë, ndërsa këta çdo javë do të mblidhen dhe do të bëjnë pazarin e bordit të radhës.

Matematika është shumë e qartë, në të gjitha vendet pa përjashtim, që kanë mbajtur qëndrimin e tyre ndaj taksave përkatëse, ulja e çmimeve ka qenë e dukshme, e prekshme, e ndjeshme për qytetarët, ndërsa këto kozmetikë, që bëjnë këta çdo javë, janë thjesht dhe vetëm qesharake qoftë në ngritjen e çmimeve, qoftë në uljen e tyre, apo të situatave kur çmimet lëvizin me 10-15% brenda 24 orëve, ku Autoriteti i Konkurrencës duhet të kishte qenë në vijën e parë për t'i ndëshkuar dhe ku të gjithë spekulantët të ndienin frikën e madhe, druajtjen e madhe për fuqinë e ligjit, duke parë këtë Autoritet, përpara se të shikonin edhe vetë qeverinë.

Është shumë e qartë se nuk ka më asnjë mundësi që kjo të ndodhë, pasi një qeveri që telekomandohet nga oligarkët, nga ata që kontrollojnë çmimet, 4-5 në karburante, 4-5 në produktet bazë të shportës, ka prioritet vetëm miqësinë dhe dashurinë e adhurimit të përbashkët si enë komunikimi, sepse shërbehen para e interesa, ndërsa qytetari është atje në fund. Sigurisht, këto institucione, të ashtuquajtura "të pavarura", të zgjedhura nga maxhoranca, do të vazhdojnë të mbeten leva të partisë për sa kohë që interesi i qeverisë për to është përpara interesit publik dhe interesit të qytetarëve. Faleminderit!